

Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

ERIONA TARTARI

QASJE EPISTEMOLOGJIKE MBI PËRKTHIMIN NË LETËRSINË SHQIPE

Shumica për të mos thënë pothuajse të gjithë shkrimtarët dhe kritikët, jo vetëm në letërsinë shqipe, por në të gjitha letërsitë, kanë lënë emrin në përkthime duke shërbyer si ura lidhëse midis kulturave dhe qytetërimeve të ndryshme. Shumë rrallë mund të kuptohet një autor, një rrymë, një dukuri kulturore, një zhanër, pa u kuptuar, ndikimi, formimi, dua të them “shartimi” i tij kulturor dhe intelektual me gjuhë, struktura mendimi, dhe qytetërime të tjera e të ndryshme prej asaj së cilës i përket. Ky “shartim” qarkullon natyrshëm, përveçse në rastet e bilinguizmit, apo të plurilinguizmit, por nëse mendohemi pak edhe në këto raste, nëpërmjet përkthimit... Por, deri tash rrallë, për të mos thënë fare, e kemi konsideruar përkthimin letrar si pjesë të pandashme të zhvillimit dhe të historisë së letërsisë, ndonëse ai është në zanafillën e vetë letërsisë së shkruar. Rrallë e pyesim veten mbi aktin e përkthimit, që është larg së qeni një aktivitet i lehtë jo vetëm si veprimtari e thjeshtë teknike, kalimi nga fjala në fjalë e nga fjalia në fjali, por edhe si përfytyrim epistemologjik; dhe pa të cilin, për të marrë shprehjen e Paul Valéry-së “*nuk do të kishim letërsi që dashurohen me njëra tjetrën*” ose për të marrë shprehjen e Kadaresë “*nuk do të kishim atë që gjermani i madh Gëte do ta quante “Weitliteratur”*”.

Çdo të thotë përfytyrim dhe pse jo qëndrim epistemologjik?

Është një çështje dhe një terren që duhet kufizuar dhe saktësuar. Faktikisht epistemologjia mund të marrë përkufizime të shumta¹.

I pari përkufizim dhe më i vjetri është përbërja e një filozofie të shkencave - duke u mbështetur në historinë e vetë fjalës. Është ligjërimi mbi dijen, dhe në fakt, autorët e studimeve dhe kërkimeve në këtë fushë janë filozofë. Si rrjedhojë, ky lloj përkufizimi do të na ftojë të pozicionoheshim filozofikisht. Por nuk është ky objektivi ynë; për të kuptuar vlerën dhe rëndësinë e përkthimit në zhvillimin e letërsisë, përveç fakteve konkrete të njohura historike ne i shtrojmë pyetjet mbi qëndrimin e përkthyesit letrar dhe zgjedhjet e tij, vështirësitë dhe problemet gjatë aktit të përkthimit, i cili mund të ngjante për nga natyra dhe procesi me aktin e shkrimit...

Atëherë një përkufizim i dytë që mund të pranohej prej nesh do ta quante epistemologjinë një lloj “shkence të shkencave”, që do të thotë një disiplinë qendrore që mbretëron mbi të gjitha shkencat dhe të cilave i jep themelet e zhvillimit. Ky lloj përkufizimi është përdorur, dhe në të shumtën e rasteve, në

¹ Autorë të njohur në këtë fushë mund të shërbejnë si një bibliografi teknike; Alain Testard, Gaston Bachelard, Jurgen Habermas, por edhe Pierre Burdieu.

mënyrë implicite. Pikërisht këtë përkufizim që vjen natyrshëm dhe që mund ta pranojmë pasi mbulohet me evidencë dhe qartësi, ne duam ta evitojmë, sepse një “shkencë” që i thotë të tjerave ç’duhet bërë dhe që vendos normat e “shkencës së vërtetë” ka një peshë të rëndë dhe autoritare. E kush mund ta thotë se cila nga epistemologjitë tashmë të përdorura dhe të zhvilluara që prej një shekulli është e mira.

Për të shmangur këtë vetëngopje, ne kemi zgjedhur dhe propozojmë një përkufizim të tretë, të cilin do ta quajmë epistemologji kritike. Nuk duhet të ngatërrohemi në shqip mbi mbiemrin “kritike”. Ky duhet të kuptohet në një kuptim të përdorimit në origjinë të tij. Është kritik një mendim që nuk mjaftohet me atë që është e dukshme dhe e prekshme, por që kërkon përtej formave të menjëhershme atë që nuk perceptohet prej shqisave dhe ndjenjave dhe që ka të bëjë me strukturën e fenomenit. Një epistemologji kritike nuk është as një filozofi në kuptimin kantian të termit, as një shkencë: ajo është një sjellje, një zakon që merr studiuesi për të ditur se ç’bën kur deklaron se bën një punë shkencore. Ajo, pra epistemologjia, nuk ka as norma për të ndërtuar, as vlera për të gjykuar, por tregon atë që është, atë që ndodh me të vërtetë kur ndërmerret një veprim intelektual, edhe ky në kuptimin kantian, me qëllim zhvillimin e dijeve.

Mbi këtë bazë dhe këtë logjikë është e thjeshtë të shpjegojmë se ç’është një problematikë... Në një kërkim, pikëvështrimi më i zakonshëm është nuanca e ekzistencës së problemeve, të cilave duhet t’u analizojmë të dhënat dhe përmbajtjen që të mundim më pas të japim zgjidhje, ose siç është zakoni modest, hipoteza zgjidhjesh. Ky formulim apo sqarim i problemeve, sado i zakonshëm qoftë kalon në heshtje një çështje themelore: atë të përkufizimit të problemeve. Dhe në fakt, në çdo rast këto duken si natyrshëm, natyrshëm të përshkruar, qartësisht të përcaktuar në ekzistencën e tyre. Por asgjë nuk është pak apo shumë e sigurt.

Që në të vërtetë të ketë problem duhet që një numër i caktuar i kushteve të mblihdet. Pa këto paraprake problemi nuk ekziston. E dimë nga përvoja banale që ajo që është problem për njërin nuk është absolutisht për tjetrin. Nuk është problemi im është formula lapidar me të cilat njëri i drejtohet tjetrit, duke vënë theksin pikërisht mbi kushtet që ndikojnë që për një person, ose edhe për një departament, një konfigurim apo një tjetër përbën ose nuk përbën problem...

Për t’u hapur e për të kuptuar më mirë, këtë që mund të na duket anekdotë ose lojë fjalësh mund ta vendosim si bindje teorike. Ne do ta përkufizojmë këtë bindje kështu: nuk ka problem veçse në raport me një problematikë të përkufizuar qartë, që do të thotë se asnjë problem nuk ekziston në vetvete pa kushtet që e mundësojnë atë.

Kjo rezervë është themelore në qasjen tonë mbi përkthimin si një çështje epistemologjike e teorive të letërsisë. Pikëvështrimi ynë është ky: përkthimi s’është vetëm një çështje gjuhe dhe zhvendosjeje, siç mund të konceptohet deri dje në katedrat tona të studimeve letrare, filologjike por edhe filozofike. Ai është qartësisht dhe me një siguri evidente një zhvendosje kulturore, zhvendosje gjithnjë e vështirë, ndofta e pamundur meqenëse çdo përkthyes në çastin e parë të punës,

Qasje epistemologjike mbi përkthimin në letërsinë shqipe

provon një ndjenjë të gjallë të pamundësisë për të përkthyer atë që është krijuar e menduar në një gjuhë tjetër. Është pothuajse i njëjti proces me shkrimtarin². Duke mos folur vetëm në rastin e letërsisë shqipe, të gjithë më të mëdhenjtë ishin fillimisht përkthyes e të kultivuar në letërsi të tjera. Duke filluar me Bogdanin, mund të shkojmë deri tek Kadareja, i cili përktheu ndër të tjerë Majakofskin në shqip, Lasgushi Gëten, Noli Shekspirin, Fishta Molierin, e pafund pothuajse të gjithë, si Pol Valery-ja përktheu Virgjilin në vargje frëngjisht, Bodelaire Edgar Poen etj., etj... Duke bërë këtë, të gjithë, këta të mëdhenjtë, kanë pasuruar gjuhën dhe letërsinë përkatëse, shqipe, frënge, gjermane... Ata në një farë mënyre i kanë dhënë qytetarinë shqiptare, franceze, gjermane autorëve të ndryshëm, sepse siç e kemi ndjerë lirikën e Gëtes u bënë lirika shqiptare sipas Poradecit. Duke përkthyer në gjuhën e një kombi, fabrikohet letërsia e tij, por nuk duhet të harrojmë, atë që e njohim mirë "*traduttore traditore*". Kjo duhet kujtuar, por nuk është synimi ynë në këtë çast, ku me gjithë tendencën teorike në fushë të studimeve letrare shqiptare, nuk duam të vëmë theksin mbi përmasën artistike të veprës origjinale, përmasë artistike kjo që presupozon një pamundësi apo pothuajse pamundësi për t'u përkthyer; këtë, teoricienë të letërsisë si Pol Valery-ja, ose edhe të tjerë, e thanë në shekullin e kaluar. Ne duam të vëmë theksin mbi faktin se përkthimi është gjithashtu dhe të paktën nga pikëvështrimi në të cilin ne i shohim gjërat, një akt social, sociologjik, kulturor në saj të të cilit një shoqëri i flet një shoqërie tjetër nëpërmjet një "kaluesi ose trapaxhiu" që është përkthyesi. Historia e ideve, e shkencave, e formave dhe e letërsive ruan emrin e trapaxhinjve të ndryshëm që kanë lejuar këtë qarkullim tekstesh të një shoqërie dhe të një gjuhe në gjuhë dhe në shoqëri të tjera. Kështu për shembull Ciceroni i fali latinishtes dhe a pajtoi atë me leksikun filozofik që i mungonte para tij, kur në dialogët e tij filozofikë i bëri të flasnin bartësit dhe partizanët e shkollave të ndryshme greke filozofike; akademikë, stoikë, epikurianë, etj. E njëjta gjë vlen për Bogdanin, i cili i fali mirëfilli gjuhës shqipe fjalorin teologjik dhe për herë të parë mendimi filozofik e teologjik filloi të strukturohej e artikulohej në shqip; e njëjta gjë vlen për Volterin që bëri aq shumë që të njëjti në Francë mendimi dhe sistemi i Njutonit, apo siç bëri dhe zhbëri në të kundërt periudha e gjatë e mbylljes së Shqipërisë, ndaj filozofive të ndryshme nga dialektikat marksiste, duke e privuar shqipen në periudhën e saj më të strukturuar, nga një pasurim i leksikut filozofik.

Përkthyesi kryen pra një akt social meqenëse i ofron shoqërisë së vet një mënyrë të menduar, një kulturë, një mendësi që i përket një shoqërie tjetër e cila përkufizohet si e ndryshme në funksion të historisë, të zhvillimit të shpirtit, të zakoneve e normave morale, të qytetërimeve që s'janë e s'kanë si të jenë universale. Duke pasur parasysh se popujt ndryshojnë shumë, se përvojnë, ndryshojnë, konceptimet e tyre për botën dhe për veten e tyre ndryshojnë në pafundësi, me një fjalë që gjuhët dhe qytetërimet e tyre përbëjnë një lloj Babeli planetar, përkthyesi, dhe në rastin tonë ai letrar, kryen një akt kulturor duke u

² Shih mbi këtë çështje tekstin e Kadaresë, *Ftesë në studio*, Vepra, Onufri, 2010.

përpyetur të rimarrë apo të përkthejë bashkë me tekstin “*historicitetin e ligjërit bartës*” që karakterizon tekstin. Mund të kujtohem këtu për një përkthim të madh në historinë e përkthimeve, domethënë për Biblën greke dhe të të Shtatëdhjetëve të Aleksandrisë, që futi për herë të parë në botën kulturore greke mendimin hebraik dhe disa shekuj më vonë vuri gjithashtu Biblën në dispozicion të Perandorisë greko-romane me tërë pasojat që solli. Gjesti i të shtatëdhjetëve në këtë pikëvështrim që një gjest prej themeluesish. Me punën e vet vigane prej përkthyesish të shtatëdhjetët kanë pasuruar gjuhën greke “koine” me shprehje, shëmbëlltyra dhe figura të stilit të veçantë hebraik, po njëkohësisht futën në shprehjen e mendimit biblik koncepte në thelb greke si ato të “logosit”.

Shihet qartë nga ky shembull i famshëm se çdo përkthim i madh dhe i vështirë është një shkëmbim midis dy gjuhësh dhe mandej dy kulturash dhe dy “botëvështrimesh”, një pasurim reciprok, një shartim reciprok. Mund të përpiqeshim për një analizë të tillë lidhur me vulgatën domethënë përkthimin latinisht të Biblës nga shën Hieronimi, ndikimi letrar i të cilit që jashtëzakonisht i ndjeshëm mbi letërsinë latine të Antikitetit të vonshëm dhe të Mesjetës, por edhe mbi letërsinë e Evropës moderne; nga poetët fetarë të mesjetës deri tek moderniteti i Migjenit dhe Kadaresë për të marrë rastin e letërsisë shqipe. Nëpërmjet përkthyesit që nuk përkthen vetëm fjalët, po atë që tregojnë “fjalët”: një sistem ligjërimi, një kontekst historik dhe social të veçantë dhe madje një emocion, një shoqëri i flet një shoqërie tjetër. Përkthyesi, si një shkrimtar i dytë, duhet të jetë i vetëdijshëm për këtë dukuri, për keqkuptimet dhe vlerësimet e gabuara, kuptimet e rreme dhe gabimet e interpretimit që përkthimi i tij mund të shkaktojë në shpirtin e lexuesit. Fjalët më të thjeshta në dukje dhe që janë të përcaktuara qartë në një gjuhë dhe në një politikë kulturore mund të mbeten të pagjetshme në një tjetër ose nëse ekzistojnë, të mos kenë po atë kuptim. Në këtë mënyrë një romanciere shqiptare e sotme Ornela Vorpsi e hap librin e vet *Vendi ku nuk vdiset kurrë* me një fjali hyrëse ironike. Ajo shkruan: “*Ja dedikoj këtë libër fjalës “përvujtëri” që i mungon leksikut shqiptar. Një mungesë e tillë mund t’i lërë vend fenomeneve të çuditshme në fatin e një populli.*” Mund të kujtojmë se Ornela Vorpsi, romanciere shqiptare e ka shkruar këtë libër direkt në italisht dhe ka bashkëpunuar për përkthimin e tij në frëngjisht. Kjo bashkatdhetare më duket se na vendos në zemër të problemeve epistemologjike që duam të ngremë sot.

Çështja e pritjes ose receptimit të veprës

Problemi i parë që qëndron para përkthyesit letrar - dhe kam parasysh, jo çfarëdo përkthyesi letrar, nga Bogdani, tek Koliqi e Lasgushi, Noli e Konica - është që ky të nxjerrë në dritë një përkthim i cili të mund të receptohet nga shoqëria për të cilën përkthimi është realizuar. Ky detyrim receptimi ose receptiviteti i mesazhit të tekstit që përkthehet shfaqet në mënyra të ndryshme duke u trajtuar ose duke u nisur njëkohësisht nga dy veçori dalluese: veçoritë e shoqërisë së origjinës së tekstit dhe veçoritë e shoqërisë së pritjes ose pse të përvetësimit, birësimit të tekstit; tragjeditë e Shekspirit të përkthyer nga Noli duket sikur janë pjesë e pandarë e letërsisë së kohës së tij. *I ligu për mend* i

Molierit, tekst i përkthyer nga Fishta, duket se është pjesë e komedisë shqipe të asaj kohe.

1. Veçoritë e shoqërisë së zanafillës

Receptimi i veprës varet në fillim nga veçoritë e shoqërisë së origjinës ose të zanafillës së tekstit po të kemi parasysh leximet dhe shndërrimet e mëvonshme të tij... Në fakt, kjo, shoqëria, ka një histori, një sociologji, ca praktika kulturore që i shërbejnë si norma sociale, domethënë që përbëjnë një kulturë të përcaktuar në gjirin e së cilës edhe individët, edhe veprat kanë kuptim. Jashtë kësaj kulture, rreziket për mospërfillje, madje edhe për keqkuptim, janë të qarta. Po të marrim një shembull bashkëkohor, do të ndaleshim tek përkthimi i një teksti mbi “laicitetin” nga frëngjishtja në shqip.

E tërheq vëmendjen sepse mund të ndeshim të njëjtin problem në gjuhë edhe për koncepte të tjera ose për arsye të ngjashme në formë. Ky term, me gjithë dallimet e vlerësimit dhe përkufizimit në vetë Francën dhe frëngjishten ku ka edhe zanafillën, përkufizon disa vlera me të cilat sot është lidhur gjithë bota dhe në dukje vlera universale, duke mbuluar një simbolikë që shënon shpirtin e francezëve, cildo që të jetë konceptimi i tij dhe që mund të shkojë nga një laicitet luftarak deri tek antiklerikalizmi, ose te konceptimi i një laiciteti të hapur që mendon se “feja s’është thjesht një çështje private, por që fetë dhe bashkësitë fetare të ndryshme marrin pjesë si të tilla në formimin e opinionit publik”, bëjnë pjesë në shoqërinë qytetare dhe kanë pra të drejtën të shprehen dhe të ndërhyjnë në debatin publik karakteristik për çdo demokraci. Pra tërë një histori politike, intelektuale, letrare dhe fetare, karakteristike për Francën, përfshihet në këtë term problematik, madje konfliktual, dhe me gjithë këtë të pranuar nga të gjithë. Mund të kujtojmë në fakt se dëshmia e parë e “laicitetit” gjendet në penën e Rousseau-it, më 1871 dhe përdoret fillimisht si rrjedhim i grindjeve të mëdha fetare të shekullit XIX^{-të}, nga të cilat ky term ruan në mënyrën e vet gjurmë në kujtesën semantike. Është për ne, dhe në raste të tjerë jemi shpjeguar pse, i njëjti koncept që u asimilua prej disa nga Rilindasit, si “shqiptari”, një shqiptari e shenjtë që do të shenjonte fenë e shqiptarit, e cila do të tregonte identitetin e tij në atë që mund të quhet sot si pikë reference identitare në të gjithë Evropën: qytetaria. Të gjithë e dimë se vargu i Pashko Vasës, një varg lapidar i kësaj qytetare “Feja e shqiptarit është shqiptaria” është interpretuar ndryshe në kohë të ndryshme; herë si thirrje nacionaliste, kur bëhej fjalë për luftë mbi pushtuesin osman, herë si thirrje ateiste, kur bëhej fjalë për nacional-komunizmin dhe ndërtimin e kultit të personalitetit.

Si ta përkthesh fjalën në gjuhë të tjera të Evropës? Dhe këtu frankofonët do të më kuptojnë, ashtu sikurse më kuptojnë albanologët, kur përpiqem të argumentoj shqiptarinë si formë qytetarie e shenjtëruar përtej çdo forme nacionalizmi të argumentuar dhe interpretuar deri sot... ose prej çdo forme ateizmi të spekuluar deri sot. Sigurisht që terma ekuivalente formalisht ekzistojnë - bie fjala të llojit anglosakson si sekularizëm - po këto fjalë janë larg së thëni atë që frëngjishtja kupton për “laicitet” dhe shqipja e Rilindjes për “shqiptari”. Dallimi s’është i kuptueshëm...

Vendet evropiane, veçanërisht në veri të Evropës, kanë përjetuar një histori krejt të ndryshme nga ajo e Francës ose nga ajo e Shqipërisë. Vendosja e protestatizmit (luterizmi, klavinizmi, anglikanizmi) si fe e krishterë shpesh e mbrojtur nga monarku, përmbajtja relative e ushtrimit të pushtetit me njohjen e të drejtave themelore, praktika për t'u marrë vesh dhe respekti për një kulturë të përbashkët kanë kontribuar për ta vendosur çështjen e marrëdhënieve midis pushtetit politik dhe autoriteteve fetare në terma krejt të ndryshme nga ajo e situatës franceze. Sa për Shqipërinë në këtë pikë situata është krejt e ndryshme. Ajo karakterizohet, pas një gjysmë shekulli persekutimi fetar të dhunshëm dhe një politike ateizmi shtetëror, që është, pra, e kundërta e një laiciteti të konceptuar drejt, nga një pluralizëm fetar dhe nga rilindja e shpejtë dhe shpërthyes e tre besimeve kryesore fetare të vendit: katolicizmi roman, ortodoksia dhe islami. Shteti shqiptar sot është vërtet laik dhe përpiqet të ruajë një qëndrim neutraliteti mirëdashës lidhur me këto tri besime. Po njëkohësisht shumë shqiptarë vazhdojnë të ngatërrojnë, si bënte dikur propaganda zyrtare e diktaturës komuniste, laicitet dhe ateizëm. Ka pra qartësisht një rrezik serioz keqkuptimi në shpirtin e lexuesit, nëse përkthyesi kënaqet duke e përkthyer fjalën vetëm me përdorimin e fjalorit. Kështu përkthimi i fjalës, për t'u kuptuar saktësisht nga lexuesi, duhet të llogarisë tërë diturinë e mëparshme dhe paragjykimet e mundshme të lexuesit. Afërsia midis fjalës "laicitet" përkthyer në anglisht me "sekularizëm" tregon tërë vështirësinë e kësaj ndërmarrjeje. Në fakt "shekullarizmi" është një situatë faktike që shpjegon si një shoqëri përkufizohet gjithnjë e më pak në praktikën dhe shfaqjet e saj, duke iu referuar vetëm një situatë efektive, po edhe një statusi juridik dhe më tepër, një vlerë themeluese të Republikës. Me fjalë të tjera, "laiciteti" është më tepër se një situatë, është një rregull. Pikërisht nga kjo matet vështirësia në përkthim, për të favorizuar një kuptim të drejtë të vetë termave që janë në lojë në një debat mbi "laicitetin". Midis gjuhëve të ndryshme, janë të shumtë miqtë e rremë dhe kur denotacioni i dy fjalëve, që nga ana tjetër janë kalk i njëra-tjetrës, është i njëjtë, konotacionet janë jo rrallë të ndryshme dhe kujtesa e tyre semantike është natyrshëm e ndryshueshme. Kjo që u trajtua për fjalën "laicitet" mund të thuhet edhe për fjalë të tjera. Në fund të fundit duhet t'i kthehemi gjithnjë metodës Sokratike, që na këshillon të mos marrim kuptimin e çdo fjale si të nënkuptuar dhe të pranuar në vetvete, por të pyesim veten për brendinë e saktë të çdo fjale në mënyrë që të kuptohemi. Me fjalë të tjera çdo koncept abstrakt dhe delikat ka nevojë të problematizohet. Kur Sokrati dialogon pranë portikut mbretëror të Athinës me falltarin Eutifron mbi mëshirën, është e qartë që filozofi dhe bashkëbiseduesi i tij se kanë që në fillim të njëjtin konceptim të fjalës dhe që do t'u duhet një dialog i gjatë për të rënë dakord apo për të konstatuar që s'janë dakord. Për ta përcaktuar më qartë çfarë themi ne mund të citojmë Heaidegerin: *Të kuptosh është tashmë të përkthesh*. Dhe prej kësaj kuptohet mjaftueshëm se përkthimi besnik matet me njohjen e shoqërisë së origjinës që është një bazë e tekstit të përkthyer. Dhe për ta përmbysur formulën e Heaidegerit mund të themi se të përkthesh do të thotë të kuptosh.

2. Veçoritë e shoqërisë së pritjes ose recepsionit

Receptimi i veprës varet nga shoqëria e pritjes domethënë ajo për llogari të së cilës realizohet përkthimi. Kjo shoqëri, si e para, është e shënuar nga një histori dhe një strukturë shoqërore që filtron tërë mesazhet e marra dhe i transformon që t'i bëjë të kuptueshme duke ia përshtatur shijes apo sistemit të vlerave të vendit të pritjes. Imagjinojmë shoqërinë shqiptare të periudhës së Realizmit socialist.

Siç e kemi parë në raste të tjera mbi historinë e përkthimeve të teksteve iluministe në shqip, se përkthimet e para të teksteve filozofike në vitet '30 ishin më tepër përshtatje se përkthime të mirëfillta, përmbledhje, me tërë kuptimin e fjalës, dhe kjo për t'u përshtatur me fjalorin, botëkuptimin dhe kërkesën e shoqërisë shqiptare të atyre viteve. Bie fjala, e njëjta gjë ndodh me përkthimet e para të Shekspirin në frëngjisht në shekullin e XVIII^{-të}, që ishin më tepër përshtatje për të ëmbëlsuar tekstin origjinal i cili dukej tepër i ashpër, domethënë gati edhe imoral dhe vështirësisht i durueshëm për shoqërinë franceze të asaj kohe. Në Odisenë e Homerit të thuash për një grua “të vdekshme” ose hyjneshë, - për të marrë gjuhën e Homerit, - që ajo është “boopis” fjalë për fjalë: “sy lopë” është një kompliment: për një kohë të gjatë përkthyesit e Homerit edhe në shqip e kanë përkthyer këtë epitete pak të përshtatshëm për shijet dhe konotacionet e kafshës me shprehjen “me sy të mëdhenj”. Sot të paktën në frëngjisht, është imponuar përkthimi liberal, sepse ka respektuar shijen karakteristike ose koloritin e origjinalit grek. Ndërkaq lexuesi duhet t'i referohet një shënimi në fund të faqes që shpjegon vlerën e epitetit homerik. Shembulli i skajshëm por që mund të jetë kuptimplotë sepse shënon një skaj, mund të merret në leximin që u bëjnë shoqëritë perëndimore shoqërive lindore dhe e anasjellta. Midis këtyre shoqërive ka marrëdhënie të ndërlikuara dhe shpesh kontradiktore.

Përkthimi i një vepre shtron pra për vetë natyrën e vet, çështjen e receptimit: domethënë marrëdhënien midis shoqërisë së origjinës dhe shoqërisë së pritjes, duke qenë e nënkuptuar se marrëdhënia s'është gjithnjë e barabartë dhe, nga ana tjetër duhen përballur pikëpamje dhe situata reale, shpesh konfliktuale. Në fakt pa idealizëm, s'mund të mendosh që përkthimet i shpëtojnë strukturës së shoqërive që ndahen në zotëruese dhe në të zotëruara. Tani, edhe e zotëruar, shoqëria e pritjes ia kundërvë mënyrat e veta të kuptimit dhe logjikën e vet asaj që shoqëria e origjinës do të përpiquej t'ia impononte po të ishte zotëruese. Situatat janë pra, të ndërlikuara. Së fundi, shoqëria e pritjes mund të “pranojë” pikëvështrimin që i imponon shoqëria zotëruese: po e bën sipas mënyrave që janë karakteristike për të. Atëherë përkthimi është një kompozim i hollë prej dy kulturave; pasoja e kësaj është shpesh trazimi i identiteteve dhe shpesh, i sfidave reale. Në këtë trazim identitetesh dhe kulturash ndodhet edhe ajo që quhet kulturë universale.

Çështja e varianteve të përkthimit në kohë

Ka shumë mundësi përkthimi në hapësirë, në një çast të caktuar, në funksion të interesave dhe sfidave të pranishme. Po duhet shtuar gjithashtu se ka shumë përkthime të mundshme në kohë: me fjalë të tjera, vargu i përkthimeve të të njëjtit tekst është një nga elementet themelore të problematikës sonë.

Variantet e përkthimeve në kohë u përgjigjen në fillim variacioneve të shoqërisë së pritjes. Kjo situatë është pasoja apo zhvillimi në kohë e asaj që ka qenë përthithur e përpunuar më parë. Është mjaft e logjikshme që një shoqëri që shndërrohet ndryshon në të njëjtën kohë marrëdhënien që ka me shoqëri të tjera.

Në këtë konceptim problematik, nëse do t'i referohemi letrave shqipe dhe periudhës së Realizmit Socialist, do të mund, jo vetëm të kuptojmë këtë periudhë dhe shoqërinë shqiptare të asaj kohe, por edhe të argumentojmë hipotezat tona teorike. Kemi mundur të shohim për vitet 44-90, hapjen dhe mbylljen e letërsisë shqipe me letërsinë e tjera jo vetëm perëndimore por edhe lindore nëpërmjet përkthimeve të ndryshme, në varësi të marrëdhënieve me shoqëritë përkatëse. Në këtë periudhë vihet re se nuk kemi më përshtatje tekstesh - siç kemi shpesh në letërsinë e viteve '30 por më tepër përkthime të mirëfillta dhe shpesh të cinguar apo të zgjedhura me interesa të veçanta dhe të parapërcaktuara. Vihet re se vendoset një element në editorinë e letrave shqipe, parathënia e detyrueshme e cila shpesh shërbente për të mbuluar, futjen e teksteve letrare që binin ndesh me ideologjinë e kohës, ose siç e përmendëm më lart për të krijuar dhe për të përgatitur shijen e lexuesit për tekstin në vijim. Për të marrë një shembull tjetër, dihet që përvojat historike të një shoqërie, në mënyrë të veçantë në fushën e politikës janë të tilla që ndryshojnë vlerësimet e dhëna mbi një periudhë të përcaktuar. Revolucioni francez është një shembull i mirë për këtë: për arsye specifike, gjatë rrjedhës së shekullit XIX^{te} dhe veçanërisht me Republikën e III^{te}, u imponua një histori "Republikane" e Revolucionit që pati si pasojë ndarjen e periudhave dhe personazheve në kategori të kundërta; revolucionarët kundër aristokratëve, malësorët kundër xhirondinëve, të mirët kundër të ligjve, momentet e favorshme kundër momenteve negative. Gjatë shekullit të XX^{te}, pas përvojave të tjera, historiografia e revolucionit ndryshoi dhe, bien fjala, periudha e quajtur si e "Terrorit" u bë objekt vlerësimesh të ndryshme: revolucionin nuk shihet më si një bllok por vihet në pah më tepër arbitrarizmi i ushtrimit të një pushteti terrorist që u bënte atentat lirive individuale, masakrat e kota, diktatura e një policie të tërbuarish dhe veçanërisht ka një ndërgjegjësim për pasojat historike të kësaj qeverie të parë totalitare të Evropës moderne: model i gjithë shteteve totalitare që pasuan, mobilizimi dhe thirrja e detyruar me armë në masë që u paraprin luftërave moderne të popujve njeri kundër tjetrit dhe, së fundi, luftërat botërore dhe miliona të vdekurit e tyre. Regjimi stalinian, totalitar që ka njohur Shqipëria është frymëzuar qartësisht prej Revolucionit francez dhe e ka reklamuar atë, në mënyrë të veçantë regjimin e Robespierit të viteve 1793-1794. Dhe sot u mësohet ende nxënësve dhe studentëve tanë vizioni stalinian i Revolucionit francez me tri etapat kryesore të një revolucionit aristokratik - duke qenë kjo një tjetër problematikë për ndërtimin e programeve shkollore të historisë dhe historisë së letërsisë - të një revolucionit borgjez dhe së fundi të një revolucionit proletar, që e arriti kulmin në pranverën e vitit 1794 me ekzekutimin e tërë revolucionarëve që s'bënin pjesë në grupin e vogël të komitetit të shëndetit publik - comité de la santé publique. Ne të gjithë e dimë këtu se ç'lexim e ç'ndikim kishte vepra e Hugo-it të madh dhe personazhet e tij të barrikadave, Gavroshi, Kozeta, në letërsinë për fëmijë të

Qasje epistemologjike mbi përkthimin në letërsinë shqipe

Realizmit Socialist. Ndërsa Rousseau-i është lexuar në shqip që në vitet '30, ai është përdorur ndryshe nga regjimi komunist në shërbim të politikës totalitare; mund të lexojmë për këtë parathënie të librit të Emilit. Pra përkthimet letrare, varen nga momenti ku vendosen dhe, pa përfshirë ndonjë lloj pandershmërie nga ana e përkthyesit -presupozimi i pafajësisë për saktësinë e punës së vet - ato shpesh ndryshojnë duke përdorur një leksik dhe një stil që i japin kuptim tjetër tekstit të fillimit duke zhvendosur një kulturë drejt një kulture tjetër dhe duke shprehur në këtë mënyrë botëkuptimin e kohës dhe të shoqërisë që i lexon.

